



Lajmet e Fundit: DVP Berat – Kapen 2 shtetas të shpallur në kërkim



21/04/2021

Elbasan/Informacion paraprak

Më datë 21.04.2021, rreth orës 14:00, në lagjen “5 Maji”, Elbasan, gjatë një konflikti është vrarë me armë zjarri shtetasi P. XH., si dhe janë plagosur shtetasit E. P., P. V. dhe E. B. Gjithashtu, në përpjekje për të parandaluar krimin është plagosur edhe punonjësja e Policisë e forcës së posaçme “Shqiponjat”, XH. S. Menjëherë në ndihmë të patrullës kanë shkuar shërbime të tjera të Drejtorisë Vendore dhe të Komisarariatit të Policisë Elbasan, si dhe janë ngritur pika kontrolli në të gjitha akset rrugore në hyrje dhe dalje të qytetit të Elbasanit. Gjithashtu, menjëherë është ngritur një grup i posaçëm hetimor i përbërë nga specialistë të hetimit të krimeve kundër personit në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, të Drejtorisë së Krimeve Kundër Personit e Pasurisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan po vijon intensivisht puna për fiksimin dhe administrimin e çdo prove materiale që do t'i shërbejë zbardhjes dhe dokumentimit të ngjarjes. Ndërkohë janë shoqëruar në Drejtoritë Vendore të Policisë Elbasan dhe Tiranë, disa persona të dyshuar se kanë dijeni apo lidhje me ngjarjen, si dhe është bërë e mundur vënia në pranga e autorit të vrasjes, shtetasi A. P., ish punonjës police. Vijon puna për kapjen dhe arrestimin e personave të tjerë të përfshirë në ngjarje.


WhatsApp Share Facebook Share Twitter Share LinkedIn Share Email

◀ DVP Berat – Kapen 2 shtetas të shpallur në kërkim

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent